



# Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti II, nr. 5, janar – mars 2022



## Ai vdes dhe ringjallët për ne

Faqe 3

(Foto: Adobe Stock)



## PAPA: "NË EMËR TË ZOTIT, JU KËRKOJ: NDALOJENI KËTË MASAKËR!"

**T**ë dielën e dytë të kreshmëve, pas luftës së Engjëllit të Tënzot, ishte kjo një thirrje prekëse e Françeskut për "t'i dhënë fund luftës", në Ukrainën e martirizuar. Papa kujtoi qytetin martir të Mariupol, që mban emrin e Virgjërës Mari, "barbarinë e vrasjes së fëmijëve e të civilëve të pambrojtur", për të cilat nuk ka asnjë arsye strategjike që mund t'i justifikojë. Foli "për agresion të papranueshëm të armatosur" e kërkoi t'u jepet fund bombardimeve dhe sulmeve, duke u ulur vërtetësisht e vendosmërisht rreth tryezës së dialogut.

"Vëllezër e motra - sapo iu lutëm Virgjërës Mari. Këtë javë qyteti që mban emrin e Saj, Mariupol, u bë "qytet martir" i luftës shkatërrimtare që po shkreteton Ukrainën. Përballë barbarive, vrasjes së fëmijëve, të njerëzve të pafajshëm, të civilëve të pambrojtur, nuk mund të flitet për asnjë arsye strategjike: por vetëm për t'i dhënë fund agresionit të armatosur, para se t'i shndërrojë qytetet në varreza. Me dhimbje në zemër bashkoj zërin tim me atë të njerëzve të thjeshtë, që kërkojnë fundin e luftës. Në emër të Zotit, të dëgjohej britma e njerëzve, që vuajnë e t'u jepet fund bombardimeve e sulmeve! Të mbështetemi vërtetësisht e vendosmërisht mbi dialogun dhe korridoret humanitare të jenë efek-

tive e të sigurta. Në emër të Zotit, ju kërkoi: ndalojeni këtë masakër!" tha Papa.

Ishte kjo një thirrje e re, e ngutshme për paqen në Ukrainë, që Papa ia drejtoi botës, nga dritarja e studios së tij mbi Sheshin e Shën Pjetrit, pas luftës mariane të Engjëllit. E më pas, vijoi: "Dëshiroj edhe një herë t'i nxis të gjithë për mikpritjen e refugjatëve, në të cilët është i pranishëm Krishti, e t'i falënderoj për rrjetin e madh të solidaritetit që u formua. U kërkoi të gjitha bashkësive dioqezane e rregulltare t'i shumëfishojnë çastet e lutjeve për paqe. Zoti është Zot i paqes, nuk është Zot i luftës, e kush e mbështet dhunën, e dhunon Emrin e Tij. Tani të lutemi në heshtje për kë vuan që Zoti t'i shndërrojë zemrat e t'i mbushë me vendosmërinë për sigurimin e paqes".

Fjalët e Atit të Shenjtë u ndoqën nga një Shesh i heshtur, i tkurrur nga një erë e ftoftë, i mbushur plot nga një turmë që i lutej Zotit për të arritur atje ku njerëzit nuk po arrijnë të depërtojnë, tek paqja. Vetëm dje, në orën e drekës, tweet-i i Papës fliste për vuajtjet e të vegjëlve. "Kurrë më luftë!" shkruhej në të! – "Në emër të Zotit, ndaluni!".

## **Ai vdes dhe ringjallet për ne**

Kreshmët e këtij viti i kaluam plot frikë, trishtim dhe ankth. Mjetet e informimit publik flasin kryesisht mbi dhunën, dëbimin e familjeve nga shtëpitë e tyre, luftën dhe vrasjen e njerëzve. Format e ndryshme të dhunës, problemet, padrejtësitë, shpifjet, intrigat, ngatërresat dhe bestytnitë që shkaktojnë vuajtje, frikë dhe pasiguri në jetën e besimtarëve, mjerisht, janë tema të zakonshme që i trajtojmë edhe në “Qendrën e Dëgjimit” pranë Misionit tonë në Luzern.

Edhe pjesët e Shkrimit shenjtë, të cilat Kisha i ka përcaktuar për lexim dhe meditim në kremtimet liturgjike dhe në lutjet personale të kohës së Kreshmëve, kohë e veçantë e përvojës shpirtërore, flasin mbi dhunën dhe intrigat, që si pasojë çojnë në vdekje (ngirije) shpirtërore, mendore ndonjë herë edhe fizike.

Mjafton të mendojmë inatin dhe xhelozinë e vëllezërve të Jozefit, birit të Jakobit, që shkaktoi aq shumë vuajtje ndaj një njeriu të drejtë dhe të pafajshëm (krh. Zan 37, 1-36).

Po ashtu tregimi mbi Suzanën biblike është plot dinakëri, akuza të rënda, dhunë psikologjike dhe emocionale të shkaktuar nga ana e pleqve intrigantë (krh. Dan 13, 1-64).

Çfarë thuhet për mbledhjen e pleqve dhe kryepleqve që me çdo kusht dëshirojnë ta qojnë në vdekje të Mirin, të Drejtin dhe të Pafajshmin? Si të kuptohet gjykimi i padrejtë i Pilatit dhe dëshira e tij për t'i larë duart me arsyetim se faji është i dikujt tjetër? Si të konceptojmë tradhtinë e Judës? Si ta pranojmë mohimi i Pjetrit? Si ta imagjinojmë dhunën e ushtarëve që pa pikë mëshire e godasin trupin e shenjtë dhe të pafajshëm të të Drejtit?

Megjithatë Krishti i pranon të gjitha: Ai hesht, lutet, vdes dhe ringjallet për ne.

Vallë, kjo që dëgjojmë dhe lexojmë është një mister apo ndoshta një mundësi e lejuar nga vetë Hyji, në mënyrë që të shfaqet në ne dashuria dhe pushteti i tij?

Ringjallja e Krishtit është festë e shpresës, e besimit dhe e jetës tonë me Krishtin e gjallë që është i pranishëm në mesin tonë. Është festa e dëshmisë se Jezusi është ringjallur dhe jeton në mesin tonë.

Festa e Pashkëve qoftë festë e ripërtëritjes së marrëdhënieve të mira ndaj Zotit dhe njeriut, e zgjimit të shpresës, e ngushëllimit dhe e përforcimit në fe!

Dashuria, mëshira dhe paqja e Krishtit të ringjallur qoftë me Ju të gjithë!

Gëzuar dhe për shumë vjet Pashkët!



(Foto: Anton Gjoni)

## MBLEDHJE E PËRBASHKËT ME STAFIN E NGUSHTË TË MISIONIT

**M**bledhjet tona mujore janë shndërruar tashmë në një metodë të mirë të vlerësimit dhe të projektimit të aktiviteteve tona të shumta që kemi në Misionin tonë.

Në mbledhjet e fundit, fillimisht kemi vlerësuar krentrimin e festave të Krishtlindjes duke konstatuar se gjërat kanë shkuar mirë, duke pasur parasysh situatën pandemike në të cilën ndodheshim. Por, si gjithmonë, mundësia për të ndryshuar dhe përmirësuar diçka është gjithnjë e pranishme.

Temë reflektimi ishte edhe katekizmi apo besimi i fesë për fëmijët dhe të rinjtë e Misionit tonë. Konsideruam të nevojshme të investojmë më tepër në mënyrat e bërjes katekizëm në më-

nyrë që edhe fëmijët edhe adoleshentët të jenë më të përfshirë.

Tema tjera mbi të cilat kemi diskutuar ishin kori i fëmijëve, plan-programi i ministrantave dhe lexuesve, si edhe revista Misioni ynë.

Duke qenë se këtë vit, revista “Misioni ynë” do të arrijë me postë tek çdo familje katolike shqiptare e Misionit tonë, kjo është arsyeja për të cilën, prej disa muajsh, po punojmë në aktualizimin dhe përmirësimin e të gjitha adresave. Deri tani kemi sistemuar dhe aktualizuar afërsisht 3000 adresa.

Duke qenë se këtë vit do të kremtojmë 30-të vjetorin e themelimit të Misionit tonë, ku mendojmë të organizojmë një festë të madhe e të bukur, ka lindur ideja e krijimit të disa komisioneve punuese të cilat do të punojnë në planifikimin dhe organizimin e festës.

Edhe shtegtimi në Lourdes (25-28 maj 2022) dhe në Padova të Italisë (13 qershor 2022) ishte temë shqyrtimi dhe vlerësimi.

Për të gjitha nevojat, planet, programet dhe aktivitetet e Misionit tonë, kërkojmë nga Hyji hire dhe bekime që gjithçka të jetë në nder dhe lavd të emrit të tij dhe për shenjtërimin tonë dhe të besimtarëve.



(Foto: m. Mrika Sabedini)



## FESTA E KUSHTIMIT TË JEZUSIT NË TEMPULL

**E**kremtja e Kushtimit të Jezusit në Tempull vë në pah porosinë dhe rëndësinë e takimit të njeriut me Zotin dhe kjo ndodh në dëftimin e Hyjit në të Njëlindurin Birin e Tij, Jezu Krishtin.

Në përkim me këtë festë është edhe dita kushtuar jetës Rregulltare, e cila festohet çdo vit me datën 2 shkurt.

Në festën e Paraqitjes së Jezusit në tempull kremtohet misteri i jetës së Tij, që lidhet me ligjin e Moisiut, që sipas tij, prindërit, 40 ditë pasi i parëlinduri të shihte dritën, duhet të ngjiteshin në tempull të Jeruzalemit për t’ia falur djalin Zotit e për pastrimin ritual të nënës (krh. Es 13,1-2.11-16; Lv 12,1-8).

Kjo e kremte na kujton të gjithëve takimin e njeriut me Zotin. Duke lexuar me vëmendje Shkrimin Shenjt, kuptojmë se në atë çast fatlum është vetë Zoti që, përmes fjalëve të Simonit plak e të Anës profeteshë, ia paraqet njerëzimit Birin e vet të Njëlindurin. “Sytë e mi panë shëlbimin” – brohoret Profeti plak, e Pro-

fetesha Ana u flet për fëmijën të gjithë atyre, të cilët prisnin Mesinë në Jeruzalem. E kështu në Tempull shpallet identiteti dhe misioni i Mesisë.

Simoni e shpall Jezusin duke e paraqitur si “shpëtimtarin” e njerëzimit, si “dritën” e të gjithë popujve, por edhe “si shenjë kundërshtimi”, sepse do të zbulojë mendimet e zemrave të shumëkujt” (krh. Lk 2,29-35).

Në këtë festë Kisha e fton mbarë popullin e Zotit t’i nderojë dhe të lutet për të gjithë ata që ja kanë kushtuar jetën Zotit me kushtin e pastërtisë, të dëgjësës e të varfërisë, duke dëshmuar kështu praninë e Zotit në çdo kohë e në çdo vend, nga dita e Paraqitjes së Krishtit në Tempull - deri në kohët tona.

Edhe në Misionin tonë në Luzern u kremtua kjo festë me kremtimin e Meshës shenjte, në prani të një numri të mirë besimtarësh.

*Shkruan: m. Mrika Sabedini*



(Foto: Besnik Qerimi)

## KREMTIMI I ZOJËS SË LURDIT

**D**itën e Zojës së Lurdit, ditë kjo kushtuar edhe lutjes për të sëmurë, përkujtojmë shfaqjet e Zojës së Bekuar vajzës së vogël dhe të varfër Bernardeta Soubirou. Lurdi ishte një qytet i vogël i panjohur dhe aspak i rëndësishëm, por kur filluan shfaqjet e Zojës në atë vend në vitin 1858, ndryshoi çdo gjë. Zoja është shfaqur Bernardetes 18 herë si Zonjë shumë e bukur e veshur me rroba të bardha. Kurse herën e gjashtëmbëdhjetë Zoja e Lurdit, Bernardetes i

është prezantuar si Zoja e Papërlyer, gjë që bindi edhe famullitarin e vendit i cili ishte mosbesues se kjo gjë mund të ishte e vërtetë, sepse Bernardeta nuk mund ta njihte këtë term. Këtë gjë ja kishte kërkuar vetë famullitari që ti kërkonte Zonjës që po shihte Bernardeta Soubirou se si e ka emrin. Në këtë mënyrë ai do të mund t'i ndërtonte asaj një kapelë në atë vend dhe që në të ardhmen të mund të vinin shtegtarët për ta nderuar dhe lutur.



(Fotos: Besnik Qerimi)

Kjo festë në Misionin tonë është kremtuar solemnisht në kishën St. Michael në Luzern. Pjesëmarrja e besimtarëve ishte e shumtë, prandaj kjo e kremte ishte edhe më madhështore. Gjithashtu edhe kori i Misionit tonë e zbukuroi këtë kremtim me këndimin liturgjik. Meshën shenjte në orën 19:30 e udhëhoqi don Anton Uka, misionar, gjatë së cilës u bë edhe ndarja e sakramentit të vajimit.

Pas Meshës të gjithë të pranishmit ishin të ftuar në sallën e Misionit tonë, ku patëm mundësi të shërbehemi me pije dhe më gjëra ushqimore. Në të njëjtën kohë ishte edhe një mundësi e mirë bashkëndarje dhe njohje me njëri tjetrin, për çka e.

Shkruan: Gjonita Lleshdedaj, Kriens



(Foto: Kristi Uka)

## FESTA E PAVARËSISË SË KOSOVËS

**M**e 20 shkurt, në Misionin tonë, Mesha shenjte është kremtuar në Goldau dhe në Sursee. Meshën shenjte në Goldau e ka udhëhequr don Kelmend Spaqi, meshtarë nga Kosova që jeton dhe vepron në Mal të Zi. Don Kelmendi ishte për vizitë tek familjarët e tij që jetojnë këtu në Zvicër.

Gjatë Meshës, don Antoni, ka pagëzuar dy fëmijë të besimtarëve tanë.

Ndërsa, Meshën shenjtë, në Sursee e ka udhëhequr famullitari i Pjetërshanit, don Marjan Uka, i cili është edhe vëllai i don Antonit, që ishte për vizitë tek vëllezërit e tij këtu në Zvicër.

Gjatë kremtimit të Meshës shenjte në Sursee

kemi kujtuar 14-të vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Lorena Gjonllshaj së bashku me disa vajza të veshura me veshje kombëtare dhe me flamurin e Kosovës në dorë duke kënduar këngën patriotike “Unë jam shqipe nga Kosova” në procesion i janë afruar altarit dhe në këtë mënyrë filloi kremtimi i Meshës shenjte. Në këtë kremtim falënderuam Zotin për lirinë e dhënë, për sakrificën e shumë pjesëtarëve të popullit tonë që kanë dhënë jetën në mënyrë që ne sot të jetojmë të lirë.

*Përgatiti: Redaksia*



(Foto: Vilson Gashi)



(Foto: Vilson Gashi)



## KORI I MISIONIT "NIKË PRELA"

(Foto: don Anton-Uka)

**T**ë shtunën, me 26 shkurt, në ambientet e Misionit tonë në Luzern, në nderë të përvjetorit të 26-të të kalimit në amshim të Imzot Nikë Prelës, ipeshkëv, u organizua Mesha e shenjtë me anëtarët e korit tonë, që bart emrin e këtij prelati të madh të Kishës tonë në Kosovë.

Imzot Nikë Prela është figurë e njohur, e dashur dhe e respektuar nga të gjithë ata që kanë pasur mundësi ta njohin drejtpërdrejtë. Veprat e tij guximtare për fe dhe atdhe tashmë janë të njohura dhe të respektuara nga të gjithë. Kujdesi i tij për Kishën që i ka qenë besuar dhe kontributi i tij për çështjen e Kosovës,

mbeten padyshim, ndër veprat më të çmuëshme të tijat.

Mbrëmjen e filluam me Adhurim të Shenjtë-nueshmit Sakrament, për të vazhduar pastaj me kremtimin e Meshës. Lutjet tona kishin si njet të veçantë paqen në botë dhe shuarjen e luftës në Ukrainë.

Pas Meshës, të gjithë të pranishmit, u takuam në sallën e Misionit dhe vazhduam me darkën e përbashkët. Takimet e tilla na dhurojnë gjithmonë ngrohtësi dhe gëzim. Kjo mbrëmje e përbashkët u shoqërua me këngë popullore të kënduara nga ne, me humor dhe me lojëra të ndryshme. Të gjitha këto

aktivitete, shpirtërore dhe miqësore, e bënë vërtetë të veçantë mbrëmjen dhe festën tonë.


Falënderimi, si gjithmonë, i shkon Zotit, përgjegjësve të Misionit tonë dhe të gjithë atyre që japin ndihmesën e tyre në mbarëvajtjen e tij. Dëshira dhe lutja jonë është që të kemi anëtarë të rinj në korin tonë.



(Foto: Besnik Qerimi)

Shkruan: Valentina  
Prenrecaj, Root





(Foto: Pixabay)

## E MËRKURA E PËRHIME DHE LUTJA PËR PAQE NË UKRAINË

**M**e të mërkurën e përhimë fillon koha e veçantë e Kreshmëve e cila zgjat 40-të ditë, pa numëruar të dielat. Gjatë kësaj kohe të shenjtë kujtojmë dhe meditojmë 40-të ditët e Jezusit të kaluara në shkretëtirë, ku ishte i tunduar prej djallit. Kreshmët gjithashtu janë kohë e dëgjimit të Fjalës së Zotit, kohë e kthimit tonë shpirtëror, kohë e pajtimit me Zotin dhe me njëri-tjetrin, kohë pastrimi dhe në mënyrë të veçantë kohë lutjeje, agjërimi dhe kohë për vepra të mira. Këto janë disa nga veprat shpirtërore që Kisha na fton t'i bëjmë gjatë kësaj kohe.

Ati i Shenjtë, Papa Françesku, ka ftuar të gjithë besimtarët në botë që të luten dhe të agjërojnë për paqe në Ukrainë. Kështu që edhe ne, stafi i ngushtë i Misionit tonë, në orën 11:00 në kapelën e qendrës sonë së bashku kemi lutur Udhën e kryqit. Ndërsa në mbrëmje Meshën shenjte që ka kremtuar don Antoni, ai ka theksuar njetin e Papës që të lutemi për paqe në Ukrainë.

Në fillim të Meshës shenjte ishte riti i përhirjes duke përsëritur fjalët e Ungjillit: “Kthelhuni e besoni Ungjillit”.

Përhirja na bën të kujtojmë se trupi i njeriut është i vdekshëm, pra është kalimtarë. Përhirja gjithashtu na bën të kujtojmë se duhet të pen-

dohemi për sjelljet tona të këqija, të jemi të gatshëm për hapa të rinj e më të mirë në jetën tonë. Hiri simbolizon pendesën dhe na ndihmon të zhvillojmë shpirtin e përvujtërisë. Kurse me agjërim arrijmë zotësinë e trupit tonë dhe fitojmë hirin, gjithashtu me pendesë mund të fitojmë faljen e mëkateve dhe meritojmë shpërblimin qiellor.

Gjatë kohës së kreshmëve lutja jonë duhet të jetë edhe më e thellë, më e sinqertë dhe më e pasur. Por me më rëndësi është, sikurse e pati theksuar edhe don Antoni në predikimin e rastit, të mundohemi të kuptojmë atë që Zoti dëshiron nga ne, të shohim më shumë atë që Ai bën për ne, në vend që të shohim atë çfarë bëjmë ne për Të. Veprat e mira bëhen duke ia shtrirë dorën atij që ka nevojë për ne, sepse nëse vërtetë jemi miq të Zotit, atëherë duhet ta vërtetojmë këtë me vepra të mira dhe nëse e duam Zotin, atëherë edhe do ta vërtetojmë me fe dhe vepra të mira.

Lutemi që Zoti të na japë këtë hir që këto Kreshme t'i kalojmë ashtu si na mëson Kisha shenjte dhe këtë ta dëshmojmë jo vetëm me fjalë por sidomos me vepra.

*Shkruan:  
m. Vida Ademi*



## RIPËRTËRITJE SHPIRTËRORE PËR FËMIJËT E MISIONIT TONË

(Foto: Nikollë Ukaj)

**M**e 12 mars, në ambientet e Misionit tonë në Luzern, nga ora 16:30, kishim ripërtëritjen shpirtërore për fëmijë, si mundësi përgatitjeje për të jetuar sa më mirë Kreshmët dhe festën e ardhshme të Pashkëve, që është festa kryesore në Kishën katolike. Në takim mori pjesë një numër i mirë fëmijësh, të shoqëruar nga prindërit e tyre.

Takimin e udhëhoqi motër Vida Ademi, ku përmes shpjegimit të periudhës liturgjike të kohës së Kreshmëve përçoi tek fëmijët dhe tek të pranishmit porosinë shpirtërore të kësaj kohe të shenjtë e të volitshme për kthim. Në bisedat e bëra më pas, don Anton Uka, misionar ka vazhduar një shkëmbim të mendimeve të prindërve dhe fëmijëve që e bëri këtë takim shumë interesant. Të gjithë së bashku janë munduar të japin ndihmesën e tyre me përvojën e vet shpirtërore dhe me shpjegimin që bëri don Antoni, që ishte shumë i pasur dhe i bukur.

Pas meditimit dhe diskutimit të përbashkët, lutem së bashku lutjen e rruzares me njetin për paqe në Ukrainë. Lutjen për paqe në Ukrainë dhe në botë e bëjmë vazhdimisht në lutjet tona të përbashkëta që Zoti të sjellë paqen kudo ku ajo mungon. Kështu na porositi edhe Papa Françesku, i cili me dhimbje të madhe përjeton gjithë këtë

masakër të tmerrshëm që është duke iu bërë një populli. Pas rruzares fëmijët patën mundësi të argëtohen përmes lojërave të ndryshme dhe njëkohësisht të shërbeheshin me pije dhe ushqime të përgatitura për këtë takim e të ofruara nga Misioni ynë. I falënderojmë fëmijët dhe prindërit e tyre që gjithmonë mundohen t'ju përgjigjen iniciativave tona për rritjen dhe formimin e tyre njerëzor dhe shpirtëror dhe falënderimi më i madh i takon Zotit që na jep këtë mundësi dhe mënyra të ndryshme për të bërë mirë.

*Përgatiti: Redaksia*



(Foto: Nikollë Ukaj)

## Aktivitet bamirësie – Prerja e flokëve

Gjatë kohës së Kreshmëve jemi të ftuar të kemi një kujdes të veçantë për të gjithë ata që për arsye të ndryshme personale dhe shoqërore, ndoshta, janë me më pak fat se ne. Këta vëllezër dhe motra tona janë të shumtë. Për këtë arsye koha e Kreshmëve është koha më e përshtatshme të mendojmë dhe të bëjmë diçka për ta, edhe pse gjithmonë duhet t'i kemi parasysh sipas mundësisë që kemi dhe nuk duhet ti harrojmë asnjë herë. Prandaj Misioni ynë mundohet të organizojë mënyra të ndryshme për t'i përkujtuar besimtarët tanë dhe për t'ju mundësuar të marrin pjesë në këtë ndihmë që është gjë shumë njerëzore, që tregon dashuri të veçantë ndaj të afërmit që kanë nevojë për ndihmën tonë.

Për të gjitha arsyet e përmendura më lart, misioni ynë të shtunën më 12 mars në mbrëmje organizoi një aktivitet bamirësie për prerjen e flokëve. Kësaj thirrje iu përgjigjen 7-të persona që merren me këtë profesion dhe një numër i mirë besimtarësh që erdhën dhe ndihmuan për këtë qëllim. Dëshira për të ndihmuar për këtë aktivitet bamirësie ka bërë që edhe besimtarët të tjerë që nuk kishin mundësi të merrnin pjesë në prerjen e flokëve, të jepnin ndihmesën e tyre edhe gjatë ditëve në vazhdim.

Nga ky aktivitet grumbulluam 1352,00 franga dhe 100 euro.

Prandaj falënderojmë përzemërsisht Lirin dhe bashkëpunëtorin e tij, Danielen, Arbnorën, Teutën, Leonardin dhe Dritën për punën e tyre të bërë me profesionalizëm. Njëkohësisht falënderojmë edhe të gjithë ata që erdhën dhe ju përgjigjen kësaj thirrje. Lusim Zotin që t'jua kthejë me të mira për ta dhe familjet e tyre.

Zoti e bekoftë Misionin tonë!

Përgatiti: Redaksia



(Foto: Gjergj Prenrecaj)



(Foto: Don Anton Uka)



(Foto: Don Anton Uka)



## TË BASHKUARA PËR BAMIRËSI

**M**ë 21 mars në qendrën tonë në Luzern është organizuar një aktivitet bamirësie me Forumin e Grave të Misionit tonë. Ftesës së bërë nga ana e Misionit iu përgjigjën shumë gra, të cilat edhe pse me angazhime të shumta, gjetën kohë që mbrëmjen e kësaj dite t'ia kushtojnë këtij aktiviteti bamirësie.

Në këtë iniciativë të gjitha së bashku kemi përgatitur pjatat dekoruese me qirinj dhe simbole tjera të Pashkëve, kurse materiali ishte siguruar prej Misionit tonë. Këto pjata me simbole të Pashkëve do të shiten në kishat tona ku kremtojmë Meshën e shenjtë në gjuhën shqipe dhe të gjitha përfitimet do të shkojnë për bamirësi. Gjithashtu edhe ndeja pas

përfundimit të punës ishte një përjetim i bukur dhe i këndshëm për të gjithë.

Në fakt, Misioni ynë gjatë kohës së kreshmëve ka ndërmarrë disa aktivitete për këtë qëllim, për çka falënderojmë Zotin dhe të gjithë bamirësit që mbështesin iniciativat tona që kanë për qëllim të mirën e atyre që kanë fat më pak se ne.

Një falënderim i përzemërt shkon për të gjitha gratë që e kushtuan kohën e tyre dhe kanë dhënë kontributin e tyre me shumë kënaqësi. Edhe ato që kanë pasur shumë dëshirë të ishin me ne, por nuk kanë pasur mundësi, i falënderojmë dhe lutemi për të gjitha.

*Përgatiti: Redaksia*



## Takimi me të rinjtë

Të dielën e tretë të kreshmëve, në ora 16:30, në qendrën e Misionit tonë në Luzern, ishte organizuar ripërtëritja shpirtërore për të rinjtë dhe të rejtat e Misionit tonë. Takimi kishte për qëllim përgatitjen shpirtërore të të rinjve, por edhe dëshirën që ata të qëndrojnë dhe të njihen më mirë mes vete. Përmes projektimit të dy videove të shkurta, të rinjtë patën mundësi ta kuptojnë më mirë kohën e kreshmëve, javën e madhe dhe festën e Pashkëve. Të rinjve, po ashtu, ju dha mundësi të bashkë-ndajnë përjetimet e tyre të pranuar nga takimi.

*Përgatiti: Redaksia*



(Foto: Emanuela Palushaj)



(Foto: Emanuela Palushaj)

## Turniri i shahut

Në mbrëmjen e 19-të marsit, Misioni ynë ka organizuar turnirin e shahut. Në këtë turnir morën pjesë shahist të shumtë nga pjesë të ndryshme të Zvicrës.

Mbrëmja ishte e këndshme dhe përplot me emocione, për çka e falënderojmë Gazmend Dedaj dhe Llesh Duhanaj, të cilëve u ishte besuar detyra e organizimit, të cilët me shumë përkushtim dhe profesionalizëm kishin organizuar mbrëmjen në të gjitha detajet. Po ashtu falënderojmë edhe të rinjtë e Misionit tonë të cilët me zell u angazhuan për pjesën teknike të turnirit (regjistrimin e kandidatëve, rregullimin e shorteve, përcjelljen e rezultateve dhe përgatitjen e ambientit).

Pas nëntë gjyrove lojë për secilin, vendin e parë e zuri Xhevdet Osamni, vendin e dytë Llesh Duhanaj dhe vendin e tretë Kolë Nushi, të cilëve, don Anton Uka, në emër të Misionit, ua ndau nga një çmim simbolik.

Turniri kishte qëllim humanitar dhe të pranishmit grumbulluan 1030 franga për çka falënderojmë secilin prej tyre.

Pas turnirit, qëndruam shoqërisht me njëri-tjetrin duke biseduar, luajtur shah dhe ping-pong.

Për këtë përvojë të mirë dhe të bukur e falënderojmë Zotin dhe të gjithë ata që mendojnë dhe punojnë për të mirën njerëzore dhe shpirtërore të njëri-tjetrit.

*Përgatiti: Redaksia*



(Foto: don Anton Uka)

**Prill 2022****01.04.2022 / Udha e Kryqit dhe Mesha shenjte**

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**05.04.2022 / E martja e 4 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**07.04.2022 / Rrëfimet e përbashkëta**

18.30 Willisau

**08.04.2022 / Udha e Kryqit dhe Mesha shenjte**

19.30 Emmenbrücke

**09.04.2022 / Mbledhja me Këshilltarët**

20.00 Luzern

**12.04.2022 / E martja e 5 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**14.04.2022 / E enjtja e madhe**

20.00 Mesha në Luzern

**15.04.2022 / E premtdja e madhe**

13.00 Udha e Kryqit në Einsiedeln

18.00 Mundimet e Krishtit në Luzern

**16.04.2022 / E shtuna e madhe**

19.00 Mesha në Inwil

22.00 Mesha në Luzern

**17.04.2022 / Pashkët**

10.30 Mesha në Goldau

13.30 Mesha në Sursee

**18.04.2022 / E hëna e Pashkëve**

10.00 Mesha në Luzern

**19.04.2022 / E martja e 6 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**26.04.2022 / E martja e 7 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**29.04.2022 / Takimi me stafin e ngushtë**

11.00 Luzern

**Maj 2022****03.05.2022 / E martja e 8 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**06.05.2022 / E premtdja e 1 e muajit**

18.30 Luzern

**10.05.2022 / E martja e 9 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**15.05.2022 / Dita e Nënave**

15.00 Luzern

**17.05.2022 / E martja e 10 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**20.05.2022 / Takim me të Fejuarit**

20.00 Luzern

**21.05.2022 / Shtegtimi në Einsiedeln**

06.00 Verkehrshaus Luzern

**24.05.2022 / E martja e 11 e Shna Ndout**

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

**25.05.2022 / Nisja për Lourdes**

20.00 Luzern

**30.05.2022 / Përfundimi i muajit Maj**

19.00 Luthern Bad

31.05.2022 / E martja e 12 e Shna Ndout

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emwmenbrücke

## Qershor 2022

03.06.2022 / E premtdja e 1 e muajit

19.30 Mesha në Luzern

04.06.2022

18.00 Mesha në Vetroz

06.06.2022 / Grill më grupet e Misionit

11.00 Luzern

07.06.2022 / E martja e 13 e Shna Ndout

09.00 Mesha në Luzern

19.30 Mesha në Emmenbrücke

10.06.2022 / Takimi me të Fejuarit

20.00 Luzern

13.06.2022 / Shtegtim në Padovë

16.06.2022 / Korpi dhe Gjaku i Krishtit

19.30 Mesha në Luzern

17.06.2022 / Takimi me të Fejuarit

20.00 Luzern

24.06.2022 / Takimi me stafin e ngushtë

11.00 Luzern

24.06.2022 / Zemra e Krishtit

19.30 Mesha në Luzern

25.06.2022 / Përmbyllja e Mësimimit të Fesë

17.00 Festa në Luzern

25.06.2022 / Mbledhja me Këshilltarët

20.00 Luzern

29.06.2022 / Shën Pjetri e Shën Pali apostull

19.30 Mesha në Luzern

# SHTEGTIMI - LOURDES 2022

Shtegtimet gjithmonë janë përvoja të bukura shpirtërore dhe miqësore!  
Falënderojmë Hyjin dhe ndërmjetësinë e Virgjërës Mari që këtë vit mund të shtegtojmë të  
Shpella e Zojës së Bekuar në Lourdes - Francë!

## NISJA:

25 Maj, ora 20:00, nga Luzerni

## KUSHTET PËR REGJISTRIM TË VLEFSHËM:

- Pajisja me 2G të vlefshme deri në fund të muajit Maj
- Dokument të vlefshëm udhëtimi
- Pagesa e paraparë për shtegtim

## KU MUND TË REGJISTROHENI?

Misioni Katolik Shqiptar Luzern  
Rodteggstrasse 6, 6005 Luzern  
Tel: 041 250 52 60 / 079 371 68 91

## KTHIMI:

28 Maj, pasdite

## ÇMIMI GJITHËPËRFSHIRËS:

350 franga për të rritur  
250 franga për 7-12 vjeçar  
200 franga për 3-6 vjeçar

## KU MUND TË BËHET PAGESA?

Konto Nr.:  
CH 94 0077 8155 5749 1200 4  
Albaner-Mission  
Rodteggstrasse 6, 6005 Luzern





(Foto: Pixabay)

**F**estën e Pashkëve në fillim Kisha e ka festuar vetëm një ditë edhe atë natën në mes të Shtunës së madhe dhe të dielës së Pashkëve. Më vonë (gjatë shek. IV) zhvillohet “Treditëshi i shenjtë i Zotërisë së kryqëzuar, varrosur dhe ringjallur”. Kremtimi liturgjik i këtyre tre ditëve fillon në mbrëmjen e të Enjtes së madhe deri të dielën e Pashkëve.

### **E enjtja e Madhe**

Të Enjten e madhe kremtohet Meshja e darkës së Mbramë që duhet të jetë e vetmja atë ditë (duke mos përfshirë këtu Meshën e shugurimit të vajrave e kremtuar prej ipeshkvit). Me Këtë meshë është e ndërlydhur tradita e larjes së këmbëve (tradihtë e ashtuquajtur mandatum – urdhër). Me këtë gjest shprehet çartë porosia e Krishtit që u jep apostujve, të jenë gjithmonë në shërbim të besimtarëve. Gjatë kësaj meshe shugurohen hostet për të Premten e madhe të cilat vendosen në një tabernakull (në kapelë ose të përgatitur për këtë rast në ndonjë vend të përshtatshëm në kishë) ku mund të bëhet adhurimi para të Shenjtërueshmit Sakrament (Varrit të shenjtë). Më pas vazhdon zbulimi i altarit kryesor, si shenjë zie e mbarë Kishës, si dhe duke marrë parasysh se të

Premten e madhe dhe të Shtunën e madhe nuk ka meshë por përkujtohen Mundimet dhe vdekja e Krishtit. Përmend këtu edhe traditën se kur thuhet Lavdia bien kambanat të cilat pushojnë e nuk bien më deri në Lavdinë e Vigjiljes së Pashkëve.

### **E Premtja e Madhe**

Liturgjia e të Premtes së madhe sot përmban tri pjesë: Shërbesën e fjalës; Adhurimin e Kryqit dhe kungimin. Kjo ditë për të krishterët në të gjithë botën është ditë agjërimi. Kisha porositi që ky agjërim të mbahet deri në Vigjiljen e Pashkëve. Në fillim të riteve të kësaj dite meshtari shtrihet para altarit, besimtarët bien në gjunjë dhe të gjithë për pak kohë luten në heshtje. Në shërbesën e fjalës vëmendja është e përqendruar në leximin e Mundimeve të Krishtit. “Kryqi, dru dhimbjesh e vuajtjesh, Iter gjaku e flije zen vendin e parë në ritet fetare”... Kështu, “me adhurimin e Kryqit besimtarët ndjekin shpirtërisht tragjedinë e Golgotës, të paraqitun aq gjallë e aq thekshëm në Ungjillin e shën Gjonit” (Meshari i të kremteve, At D. Gjeçaj, Romë 1966). Pas leximit të Mundimeve të Krishtit mbahet një homili e shkurtër dhe vazhdohet me lutjet e gjithmbarshme. Më pas bëhet



adhurimi i Kryqit për të përfunduar me pjesën e tretë që është pjesa e kungimit. Sot, më mirë se kurrë, e kuptojmë se të kungohesh me Korpën e Krishtit d. t. th. të marrësh pjesë në flinë e tij – të dish t`i pranosh edhe vuajtjet nga dashuria për të afërmin.

### **E Shtuna e Madhe**

Në këtë ditë nuk ka kremtim Eukaristik dhe as të shërbesës së fjalës, por me mendje e zemër lutemi duke përkujtuar Krishtin në varr i cili pret momentin e ngjalljes së vet të lavdishme.

### **Vigjilja e Pashkëve e Natës së shenjtë**

Vigjilja e Pashkëve sot përmban këto katër pjesë: 1) Shërbesa e dritës: Bashkësia gjendet afër qiriut të Pashkëve që është simbol i Krishtit, dritës së botës. 2) Shërbesa e fjalës: Ku mendojmë mbi veprat e mrekullueshme të cilat Zoti i ka bërë në popullin e vet që nga fillimi. 3) Shërbesa e pagëzimit: Sakrament ky përmes të

cilit kemi kaluar nga vdekja në jetë. Bëhet përsëritja e premtimeve të pagëzimit, dhe 4) Shërbesa eukaristike: Populli i Zotit i rilindur me pagëzim paraqet flinë në Përkujtim të Krishtit, si shenjë falënderimi dhe ushqehet me Korpën e Krishtit të ngjallur. Shën Agustini për këtë natë shkruan kështu: Nata e Pashkëve është “Nata shenjte, nata nënë e të gjitha netëve të krishterimit”.

### **Koha e Pashkëve**

Koha e Pashkëve zgjat 50-të ditë. Fillon me Vigjiljen e Pashkëve dhe përfundon me të dielën e Rrëshajëve. Gjatë kësaj kohe përkujtojmë ngadhënjimin e Krishtit mbi vdekjen. Është kjo kohë gëzimi, pra, për të kënduar edhe ne “Alelujen” e liturgjisë duhet të ringjallemi shpirtërisht me Krishtin duke filluar një jetë të re hiri.

*(Ky shkrim është shkruar nga don Agim Qerini, gjendet në faqen zyrtare të Misionit tonë dhe është përshtatur për këtë numër të revistës sonë)*

### **Përsiatje**

O Zot i dashur, me keqardhje të thellë duhet të pranojmë që mundimet më të rënda i merr prej nesh. Na fal, o Zot, që pas çdo tradhtie vijmë dhe e puthim fytyrën tënde e ti përsëri na pranon me butësi dhe dashuri. Na fal që shpesh bëhemi edhe frushkull dhe godasim pa mëshirë në trupin tënd. E atëherë kur kemi më së shumti nevojë për praninë tënde, shndërohemi në ata ushtarë mizor që të flakin tutje.

Na fal, po të lutemi, kur para syve të ndërgjegjes tonë kemi të mirën, e ne vazhdojmë ta ndjekim dhe ta bëjmë të keqën. Na fal sepse dashuritë dhe kënaqësitë e rrejtshme të kësaj bote, shpeshherë, i pranojmë para dashurisë dhe kënaqësisë që vjen prej Teje. Na fal që në drurin e Kryqit jemi ne ata që më mëkatet tona Të shporojmë duarsh dhe këmbësh.

Të falënderojmë, o Jezus, sepse edhe ne, si mëkatarin e penduar, me gjithë zemër na fal, na pranon dhe na bënë pjesëtar të dashurisë sate të përzetshme.

*Shkruan:  
Valentina Tahiri Duzhmani, Inwil*



(Foto: Besnik Qerimi)

## SEMINARI SHPIRTËROR

**S**ikurse trupi ka nevojë për ushqim dhe ushtrim të vazhdueshëm në mënyrë që të mbetet i shëndosh dhe të funksionojë mirë, po ashtu edhe mendja dhe shpirti kanë nevojë për ushqimet e veta, përndryshe do të mbesin të vdekur.

Misioni ynë, në forma të ndryshme dhe me propozime të shumta, mundohet, për çdo ditë, të ju ofrojë besimtarëve atë ushqim që më të vërtetë e freskon dhe e gjallëron jetën shpirtërore dhe atë mendore. Kjo është arsyeja e aktiviteteve tona, takimeve, organizimeve, shëtitjeve, ripërtëritjeve shpirtërore, veprave të bamirësisë e shumëçka tjetër që organizon Misioni ynë gjatë gjithë kësaj kohe të shenjtë dhe kohës gjatë vitit.

Gjatë këtyre ditëve kishim Seminarin shpirtëror, pikërisht sepse donim që të ju ofronim besimtarëve një mundësi takimi me njëri-tjetrin, me Fjalën e Hyjit dhe me vetë Hyjin të pranishëm në Eukaristi. Tema e seminarit ishte: Ecja kreshmore. Seminari zgjati prej 24 – 26 mars të këtij viti. Dita e parë ishte në Qendrën tonë në St. Michael në Luzern. Pas ligjëratës së mbajtur të don Shan Zefit, ishte kremtimi i Mes-

hës shenjte për të gjithë të pranishmit. Dita e dytë pasi që ishte e premtë, seminari është zhvilluar në Emmenbrücke, ku filluam me lutjen e rruares kushtuar Zojës së Bekuar për paqe në Ukrainë, pastaj udhën e kryqit, e më pas Mesha shenjte e kryesuar nga don Shani që e kishte edhe homelinë e rastit. Ditën e tretë Seminari është zhvilluar në Qendrën tonë në sallën e madhe e cilat ishte e mbushur plot me besimtarë ishte ligjërata dhe pas saj ishte mundësia për pyetje, të cilat ishin të shumta dhe mirë të formuluar nga ana e besimtarëve tanë, ku është parë edhe interesi i tyre mjaftë i mirë. Vazhduam me Meshën shenjte në kishën e famullisë St. Michael dhe gjatë gjithë kohës ishte edhe mundësia për rrëfim dhe pajtim me Zotin në këto ditë të shenjta.

Të premten e 25 marsit, sipas porosisë së Papa Françeskut ishte ditë lutje për paqe në Ukrainë. Edhe bashkësia e Misionit tonë në Luzern, ashtu siç vepruan të gjitha bashkësitë e botës katolike, ju bashkua ftesës së Papës që të lutet për paqe. Gjatë Meshës së shenjtë, don Shan Zefi, vikar gjeneral i dioqezës Prizren-Prishtinë, në predikimin e rastit, veçoj rëndë-



(Foto: Besnik Qerimi)

sinë e lutjes në tejkalimin e situatave të vësh-tira dhe të konflikteve të ndryshme që mund ta përfshijnë jetën e njeriut. Kurse don Anton Uka, në fund të Meshës, luti një pjesë të lutjes së Kushtimit Zojës që Papa e kishte përpiluar enkas për këtë ditë. Prania e madhe e besimtarëve e bëri edhe më solemne kremtimin dhe lutjen tonë.

Seminarin shpirtërorë e drejtojë don Shan Zefi i cili kryesisht foli për Kreshmët dhe porosinë e tyre në jetën shpirtërore dhe njerëzore të njeriut. Në meditimet e tija, don Shani, gjithashtu ka theksuar edhe sakramentin e rrëfimit, rrëfimin e mirë dhe të sinqertë, pendesën dhe domethënien e saj, duke porositur besimtarët ta praktikojnë dhe të jenë të pajtuar me Zotin dhe me të tjerët.

Përveç meditimeve të dëgjua, të pranishmit kishin mundësi të shkëmbenin përvojën e tyre shpirtërore. Moment i bukur ishte edhe



(Foto: Besnik Qerimi)

ndeja e përbashkët duke u shërbyer me pije apo me ndonjë ushqim që ishte përgatitur për të pranishmit.

Për gjithçka e falënderojmë Zotin që na jep mundësinë të përjetojmë momente të tilla të bukura me besimtarët tanë.

*Shkruan: Redaksia*



(Foto: Gjokë Bisaku)



## «VISHUNI ME MIRËSI»

(Foto: Pixabay)

**N**ë biseda të ndryshme individuale, intime, miqësore, familjare, grupore, kolektive, shoqërore, shpesh dëgjoher të thuhet, e kjo me bindje e dëshpërim, se nuk ia vlen të jesh i/e mirë, nuk ia vlen të jesh i sjellshëm, të bësh mirë, të jesh modest, të jesh i sqjertë, të jesh korrekt, i ndershëm, nuk ia vlen të shfaqësh vlere e virtyte, nuk ia vlen të jesh vetvetja... Sepse në rrethin shoqëror në të cilën jetojmë e bëjmë pjesë, njeriu më shumë vlerësohet, shqetësohet, për paraqitjen, se sa për përmbajtjen apo brendinë e tij. Me një fjalë, për vlerat dhe virtytet nuk ka vend, nuk ka kohë, nuk ka vlerësim, por, përkundrazi ato shpesh konsiderohen si dobësi. Me keqardhje, duhet thënë se: njerëzit tashmë janë të bindur, kanë krijuar një përvojë të tillë, dhe kanë arritur në një përfundim, se vërtet nuk ia vlen të dhurosh mirësi! Kjo gjendje, është shumë e dhimbshme dhe shqetësuese. Duhet të pyesim, të kërkohet dhe të gjejmë shkakun pse shoqëria jonë, unë, ti, ka arritur deri në këtë gjendje? Cila është arsyeja që mirësia të na duket e pavlerë, dhe e padobishme? Pse virtyti i mirësisë perceptohet si dobësi!?

Ajo që vihet re gjithnjë e më shumë është fakti, se njeriut të sotëm nuk i intereson më

thelbi, bota e brendshme e individit, porse nëvëmendjen e tij ngjall më shumë interes dhe përkushtim paraqitja, dukja e jashtme. Vlerësohesh nëse vishesh me rrobat e modës së fundit, nëse ke telefonin e fundit që ka dalë në treg, nëse ke tatuazh, pirsing, nëse ke tjetërsuar veten me ndonjë ndërhyrje kirurgjikale të panevojshme vetëm që të dukesh “më bukur”, nëse di të gënjesht, nëse ngre zërin e këtë sidomos përballë të pambrojturve, nëse di të shfaqesh sa më fallco, sa më hipokrit. Vlerësohesh nëse di të luash role për të arritur interesat personale, nëse shfaq sa më shumë fytyra, nëse silllesh sa më arrogant, nëse flet negativisht për të tjerët, nëse je sa më dredharak, nëse nuk je vetvetja... Mirëpo se ku po na çon e ku do të na çojë kjo gjendje, pak kujt i intereson! Asnjëherë nuk duhet harruar se mirësia gjithmonë dhe gjithkund ka dobënë dhe vlerën e vet, si për individin, ashtu edhe për tjetrin e shoqërinë në përgjithësi. Asnjëherë nuk duhet dyshuar në dobëtë e jashtëzakonshme të mirësisë. Pavarësisht mungesës së vlerësimit ndaj saj, gjithmonë të dhurohet sa më shumë mirësi ndaj vetes, ashtu edhe ndaj tjetrit, sepse aktet e mirësisë janë një nga mënyrat më të mira për ta frymëzuar tjetrin.

Pra, nuk duhet të ndalemi, e të lodhemi duke dhuruar mirësi. E këtë na e kujton edhe Shën Pali në letrën drejtuar Galatasve «Mos të lodhemi kurrë duke bërë mirë; për të vërtetë nëse nuk do të mejmë, patjetër në kohën e duhur, do të korrim. Prandaj, derisa të kemi kohë, t'i bëjmë mirë gjithkujt...» (Gal.6,9-10) Pra, mirësia asnjëherë nuk është e pavlerë dhe e padobishme. Por, në kohën e duhur do të marrim atë çfarë na duhet dhe kemi nevojë si shpërblim të mirësisë. Duhet të bëhemi të vetëdijshëm se ajo nuk është vetëm një formë mirësjelljeje për të lënë njëpërshtypje pozitive kundrejt tjetrit, nuk duhet të jetë një qasje hipokrite me qëllim nëvetvete, nuk është vetëm thjeshtë të bësh diçka të mirë për dikë, por është një virtyt i pandashëm i formimit të personalitetit tonë. Pra, mos kini turp që të visheni me mirësi, por bëni që të tjerët të turpërohen nga mirësia juaj. Të vishemi me mirësi, na e këshillon edhe Shën Pali në letrën drejtuar Kolosianeve: «Vishuni, pra, mbase jeni të zgjedhurit e Hyjit, e shenjtër e të dashur me zemër të dhimbshme, me mirësi, me përvujtëri, me butësi e me duresë.» (Kol 3, 12) Kush është i veshur me këtë virtyt ka brenda vetes edhe vlera të tjera si; respektin, mirëkuptimin, zemërgjerësinë, thjeshtësinë, dhembshurinë, dashurinë, të cilat janë të nevojshme e të domosdoshme për personin dhe shoqërinë. Kështu, kuptohet që kemi të bëjmë me një person që ka dinjitet e personalitet të formuar dhe të edukuar. Kërkohet edukim, formim, angazhim, vullnet, e qëndrueshmëri. «Mirësia është rezultati i punës me veten.» (Papa Gjoni XXII) Ne mund ta kemi këtë virtyt, të kemi mësuar dhe të jemi edukuar rreth këtij virtyti, por nëse nuk angazhohemi që ta ruajmë si vlerë dhe dhuratë, ai mund të zbehet e pastaj të na duket i pavlerë. Shën Nënë Tereza thoshte: «Tregoje mirësinë në fytyrë, në sy, në buzëqeshjen tënde.» Janë pikërisht, gjestet e vogla që flasin e dëshmojnë mirësi. Mënyra sesi flasim, si komunikojmë, dialogojmë, qëndrimet që mbajmë, si

i drejtohem tjetrit, si ia shtrijmë dorën, si e shikojmë, si i menaxhojmë situatat, pra, përfshihet gjithë personaliteti i personit. Kjo ka të bëjë jo vetëm kur jemi nën vëzhgimin e të tjerëve, por edhe kur jemi vetëm. Personi që është i veshur me mirësi, nuk ka nevojë ta ngrejë zërin, apo të bërtasë, nuk ka nevojë të çajë me bërryla për të arritur diku dhe diçka, nuk ka nevojë që të tregojë se ç'vlera ka, nuk pret duartrokitje e vlerësim nga të tjerët, por i mjafton qetësia e brendshme shpirtërore që reflektohet më së miri së jashtmi. Mjafton heshtja, matura, thjeshtësia dhe urtia. Sepse mirësia nuk ka nevojë për fjalë, por mjafton shembulli dhe sjellja e mirë që lë mbresa e gjurmë tek të gjithë e mbetet në kujtesën e të gjithëve. Ja se çfarë duhet thënëme zë të lartë: mos lejoni që veset dhe dobësitë t'ia zënë frymën këtij virtyti kaq të çmuar. Mos e kërkoni diku jashtë sepse nuk mund ta gjeni, ajo vjen nga zemra dhe është fryt i shpirtit. Shën Pali thotë: «Fryt i shpirtit është mirësia.» (Krh.Gal.5, 22) Mirëpo, që virtyti i mirësisë të vlerësohet, dhe të jetë sa më i pranishëm në shoqërinë tonë, një detyrë dhe përgjegjësi e madhe u takon prindërve. Familja është vendi, shkolla e parë, ku fëmijët mësojnë dhe edukohen, mes tjetërash, për rëndësinë e virtyteve dhe vlerave. Fëmijët që gjatë formimit dhe arsimimit, kultivojnë brenda tyre mirësinë, dhe qënë të ardhmen do bëhen tërëritur qëdo dinë gjithmonë e gjithkund, ta shfaqin atëpa ndërëasnjëloj ngurrimi dhe vështirësie, duke i dhënë rëndësinë e duhur për veten dhe mbarë shoqërinë. Mbajeni veshur gjithmonë mantelin e mirësisë, dhe mos e hidhni atëpërballë çfarëdo situatë. Jepuni arsye të tjerëve se ia vlen ta vlerësosh mirësinë. Mos kini turp të shfaqni mirësi, dhe mos humbni kohë duke menduar nëse ajo është dobësi apo virtyt! Mos dyshoni në dobinë e saj! Dhuroni sa më shumë mirësi!

*Shkruan: m.Franciska (Suzana) Lekaj*

## Mesha shenjte

Mesha shenjte është themeli dhe qendra e jetës tonë të krishterë. Asnjë devocion dhe asnjë përshtirë tjetër nuk mund ta zëvendësojë kremtimin Eukaristik.

Në Misionin tonë, përveç të dielave dhe festave, nga dita e marte, deri të premtën, në orën 9:00 kemi kremtimin e Meshës shenjte. Të shtu-nave e kemi Meshën në ora 10:00, ku do të bëhet edhe pagëzimi i fëmijëve. Prandaj, nëse gjatë këtyre ditëve të javës ke mundësi për të marrë pjesë në Meshë, mos ja moho vetvetes këtë përvojë takimi me Krishtin dhe me njëri-tjetrin.



(Foto: Gjokë Bisaku)

## Pagëzimet

Kisha rritet në numër dhe shenjtëri përmes sakramentit të pagëzimit.

Çdo të shtunë në orën 10:00, në Luzern, dhe në çdo vend ku kremtojmë Meshën shenjte sipas datave dhe orëve në kalendar, është



(Foto: Ndreçë Thaqi)

mundësia e pagëzimit të fëmijëve tuaj. Po ashtu, të gjithë ata që duan ta përdorin sallën e Misionit tonë për festa familjare apo raste tjera, gjithmonë është e mundshme nëse ajo rezervohet më parë.

Lajmërimi është i domosdoshëm!

## Përgatitja për Krezmim

Me kërkesën e Kishës vendore këtu në Zvicër, nga viti 2022, krezmimi do të ju ndahet vetëm atyre të rinjve dhe të rejave që kanë mbushur moshën 18-të vjeçare. Kështu që, të gjithë të rinjtë dhe të rejtat që kanë për tu krezmuar, kemi filluar besimin (përgatitjen) për këtë përvojë të rëndësishëm të fesë.

Besimi mbahet në Luzern, çdo të shtunë duke filluar nga ora 17:30.

## Përgatitja për Kurorëzim

Familja e bashkuar është bërthama e një shoqërie dhe kisha të shëndoshë.

Përgatitjet për kurorëzim kishtar kanë për qëllim vetëdijesimin ndaj përgjegjësive që të martuarit kanë ndaj njëri-tjetrit dhe familjes.

Prandaj, të gjithë ata që kanë për tu kurorëzuar gjatë vitit 2022, i ftojme që të lajmërohen në qendrën e Misionit tonë.

Kalendari i takimeve përgatitore për kurorëzim kishtarë është në këto data:

20 maj 2022, ora 20:00, në Luzern;  
10 qershor 2022, ora 20:00, në Luzern;  
17 qershor 2022, ora 20:00, në Luzern.



(Foto: pixabay)

### Përkujtimi i të vdekurve

Kujtimi dhe lutja për të dashurit tanë, që tashmë kanë kaluar në Amshim, është detyrë dhe përgjegjësi e secilit prej nesh, aq më tepër në përkujtimin e ditës apo të datës të vdekjes së tyre. Prandaj, ata të cilët dëshirojnë t'i përkujtojnë të vdekurit e tyre me Meshën e shenjtë, janë të lutur të lajmërojnë së paku një javë më parë dhe, mundësisht, të jenë pjesëmarrës në kremtimin e Meshës së kremtuar për të dashurit dhe të afërmit e tyre.



(Foto: pixabay)

### Qendra e dëgjimit

Duke e parë nevojën e shumë njerëzve për t'i dëgjuar, këshilluar dhe ndihmuar në kapërcimin e sfidave dhe problemeve të tyre, para 6-të muajve, kemi vendosur që në Misionin tonë të bëjmë hapjen e një Qendre të Dëgjimit.

Kjo Qendër është e hapur çdo të shtune, paradite. Nëse rastet dhe nevojat janë urgjente, rezervimi është i mundur edhe për ditët tjera të javës. Seancat apo takimet i udhëheq don Anton Uka, ato zgjasin 45 minuta.

Rezervimi është i detyrueshëm.

### Të martet e Shna Ndout

Në vitin 2022 të martet kushtuar Shna Ndout fillojnë me 15 mars. Devocioni i 13-të të Marteve kushtuar shenjtit të dashur të mrekul-

live të shumta është një traditë e lashtë e Kishës dhe shumë e dashur për besimtarët tanë.

Në Misionin tonë do të kemi dy Meshë të shenjta:

Luzern, në orën 9:00,

Emmenbrücke, në orën 19:30



(Foto: Besnik Qerimi)

### Të premtet e para të muajit

Të parat premtet të muajit ndërlidhen me përshtirësinë e besimtarëve ndaj Zemrës së Krishtit.

Çdo të para Premtet të muajit, në orën 18:30, në Luzern, kemi adhurimin e Krishtit në Eukaristi dhe menjëherë pas kremtimin e Meshës shenjte.



(Foto: Besnik Qerimi)



## MOTËR JOSEPH MICHAEL EPRORE E RE E MISIONAREVE TË BAMIRËSISË

**M**otër Joseph Michael është zgjedhur nga Kapitulli i përgjithshëm i Kalkutës dhe zë vendin e motër Premës.

Indiania 68-vjeçare motër Joseph Michael, është eprorja e re e Misionareve të Bamirësisë, të njohura si motrat e Nënë Terezës. U zgjodh nga Kapitulli i përgjithshëm i motrave, mbledhur në Shtëpinë nënë të Kalkutës. Zë vendin e motër Premës, me origjinë gjermane, e cila u priu për dy mandate motrave, që nga viti 2009.

Motër Joseph bëhet kështu rregulltarja e katërt e thirrur për t'u prirë motrave me sarin bardh e blu, i njohur në mbarë botën për shërbimin që u bën të varfërve më të varfër.

Pas Shën Nënë Terezës, themeluese e Misionareve të Bamirësisë, që ndërroi jetë në vitin 1997, për të drejtuar kongregatën u thirr motra nepaleze Nirmala Joshi, e cila themeloi edhe degën kundruese të motrave.

Motër Joseph është indianja e parë që merr mbi vete detyrën e eprores së përgjithshme. Me origjinë nga Thissur, në Jerala, hyri në rad-

hët e Motrave të Bamirësisë kur ishte vetëm 20-vjeçare. U bë menjëherë një nga bashkëpunëtorët më të ngushta të Nënë Terezës. Ishte në mision edhe në Filipine e, më pas, në Poloni e në Papua Guinea e Re.

Aktualisht jetonte në Shishu Bhavan (Shtëpia e pritjes së fëmijëve) të Ernakulam, ku ishte eprore e Misionareve të Bamirësisë për Keralanë. Deri 15-të muaj më parë ishte asistente e përgjithshme, përkrah Motër Premës. Nga Ernakulam, motra John Mariette e komenton kështu, në Asia News, këtë zgjedhje: "Jam e sigurt se Zoti do t'i përdorë të gjitha talentet dhe cilësitë e saj, për t'i bërë mirë shoqërisë, sipas planeve të Tij".

Në kapitullin e Misionareve të Bamirësisë - që zgjodhën edhe Këshillin e Përgjithshëm në ndihmë të Eprores Joseph - morën pjesë edhe përfaqësues të të gjitha bashkësive të Urdhërit, sot i pranishëm në 110 vende të botës.





**A**jo çka po ndodh në zemër të Evropës së krishterë, katolike, ortodokse e ungjillore, vërteton në mënyrë të pakundërshtueshme se kontinenti është në kthetrat e krizës shpirtërore. Historia përsëritet, jo ndryshe, por si në fillim të shekullit të fundit të mijëvjeçarit të dytë. Vërejmë qëndrimin indiferent moral të institucioneve politike e civile ndaj fesë së krishterë, ashtu si në zemrat e atyre, që qeverisin popujt e marrin vendime për jetën e tyre.

Kulti, që i përket vetëm Zotit dhe kultura e drejtësisë dhe e paqes, që buron nga Ungjilli, ia lëshuan vendin idhujtarive të reja, në rritje. Më e dëmshmjja, që synon të absolutizohet në gjirin e shoqërive tona moderne, është idhujtaria e unit, egolatria. Prireja e “unit” për t’u bërë Zot nuk është aspak e re. Është e vjetër sa Kulla e Babelit, e përshkruar në Librin e Zanafillës. E lashtë, sa mëkati i parë i Evës dhe i Adamit, që u tunduan nga djalli dhe na humbën parajsën!

Shkaqet e lindjes së egolatriisë në shoqërinë moderne janë të panumërta e shkatërrimtare. Synojnë ta rrënojnë njeriun, dinjitetin e tij, ta çrrënjosin të vërtetën biblike, mbi të cilën ngrihet qytetërimi ynë perëndimor, që na kujton se “Zoti është Zot, njeriu, njeri!”.

Njeriu perëndimor sot ka nisur të besojë se është ai vetë Zoti! E të ndërtojë “Kullën e re Babelit”, e cila sot po lëkundet përsëri në themel nga bombat e nga tmerrri i një lufte, që mund ta flakë copa-copa në eter planetin tonë të lashtë, me

gjithë fitoret e humbjet e historisë së tij! E me gjithë “zotërinjtë e bombave atomike”. Të duket se njeriu nuk mësoi asgjë nga historia e nuk do ta kujtojë se të gjitha përpjekjet për ta zëvendësuar Zotin me njeriun patën funde nga më tragjikat: diktaturat, totalitarizmat, luftërat, vrasjet, shfarosjet në masë!

O i krishterë! E edhe ti, o Njeri! Njihe dinjitetin tënd - nxiste Leoni i Madh, Papa i shekullit V, që pa fundin e perandorisë së Cezarëve, e frenoi furinë luftarake të Atilës, “kamxhikut të Zotit”. Mos harro kush është Kryet tënd, e kush, korpi, gjymtyrë e të cilit je! Kujtoju se u shkëpute nga terrinat, për të dalë në dritën e Zotit. E se çmimi i paguar për çlirim tënd nga skllavëria, është Gjaku i Krishtit!

E mos harro se në venat tua prej qytetarësh evropianë e perëndimorë vlon i njëjti gjak: gjak i krishterë. Jemi të krishterë, para se të jemi ukrainas, rusë, italianë a shqiptarë. Jemi gjymtyrë të të njëjtit Korp, të të njëjtit fis. Dashtë Zoti e na zgjoftë nga ëndrra jonë mediokre, për të na rindezur me dashurinë e tij të pambaruar. Nuk është koha për të qarë, as për ta braktisur fushën e betejës: është koha për t’u kthyer tek Zoti. Nuk është koha për të gjykuar e për të protestuar. Zoti na pret. Ta rifillojmë ecjen në rrugën e Tij, do të thotë t’i japim fund çdo lufte e të fillojmë rindërtimin e një bote, mbi të cilën nuk sundon uni, por Zoti! Sundon e fiton me dashuri, jo me bomba atomike, flakur nga të krishterët për të derdhur gjak të krishterë. Duke i ftuar bijtë t’ua rikthejnë vendin e parë ligjeve të Tij.

*Marrë nga Radio Vatikani*

Luzern, mars 2022

## THIRRJE PËR DONACION

Të dashur vëllezër dhe motra!

Misioni Katolik Shqiptar në Luzern në këtë vit, më 22 dhe 23 tetor, do të kremtojë 30-të vjetorin e themelimit. Misioni tash tridhjetë vite me përkushtim të plotë vazhdon të punojë për të mirën shpirtërore, kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve katolikë që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër. Misioni ynë këto vlera i kultivon dhe ndan njëkohësisht me të gjithë shqiptarët e përkatësisë fetare islame apo edhe ortodokse.

Që festa jonë të jetë më e përgatitur dhe më madhështore, jemi të varur nga ndihma dhe kontributi Juaj. Prandaj, për të kuptuar më saktë qëllimin e donacionit Tuaj, Ju lutemi ta shënoni fjalën kyçe „Jubileu i Misionit“.


Duke Ju falënderuar qysh tash për mbështetjen Tuaj, njëkohësisht Ju ftojme të përgatiteni shpirtërisht për pjesëmarrje në këtë manifestim të rëndësishëm.

Zoja e Këshillit të Mirë, pajtorja e Misionit dhe e popullit tonë shqiptar, ndërmjetësoftë për ne dhe familjet tona

*Jon Anton Uka*

*Don Anton Uka*

*Përgjegjës i Misionit*



**Konto:**  
**CH24 0077 8155 5749 1200 3**  
**Albaner Mission**  
**Rodteggstrasse 6**  
**6005 Luzern**



Don Anton Uka  
**Në fillim ishte dëgjimi**

“Autori, përmes pesë kapitujve të këtij vëllimi, duke e ndjekur itinerarin martinjan, e vendos lexuesin, në një ecje që karakterizohet nga pesë etapa të cilat në mënyrë sistematike, fillimisht, e vetëdijësojnë njeriun për thirrjen e madhe në të cilën është i ftuar, pastaj e forcon (rikrijon) me forcën e Fjalës, e aftëson përmes Eukaristisë me qëllim që ta bëjë misionar dhe dëshmitar të dashurisë. Pra, heshtjen soditëse, forcën e Fjalës, aftësinë e Eukaristisë, dëshminë misionare dhe fuqinë e dashurisë, Autori e paraqet si një mozaik të vetëm, ku secila pjesë e tij përjetohet, shpjegohet, interpretohet dhe jetohet në veçantinë dhe origjinalitetin e vet.

Sfidave të shumta, që e karakterizojnë botën tonë materialiste dhe konsumiste, ku aktivizimi i tepruar dhe frustrues paraqitet si e vetmja mundësi për të qëndruar dhe përballuar nevojat e kohës në të cilën jetojmë, Don Antoni, duke i analizuar Letrat Baritore të Martini-t, në mënyrë paradoksale (anakronike) me botëkuptimin e kohës, njeriut të mbytur në zhurme i propozon heshtjen soditëse, si parakusht për pranimin e Fjalës dhe si vend teologjik (locus theologicus) për të arritur te thelbi i vetës së vet”.

*Mons Dodë Gjergji, Ipeshkëv*



Don Anton Uka  
**Etika e edukimit**

“Propozimi i tij edukues i është drejtuar njerëzimit në tërësi; njeriut si të tillë, pavarësisht nga koha dhe vendi ku gjendet; shoqërisë në përgjithësi dhe shoqërisë së sotme; Kishës së gjithmbarshme dhe Kishës vendore (dioqezave, famullive dhe grupeve të interesuara); familjes në përgjithësi dhe familjes së krishterë në veçanti; edukatorëve që janë të tillë në sajë të thirrjes natyrore (p.sh. prindërve) dhe edukatorëve që janë të tillë në sajë të thirrjes profesionale, apo misionit të tyre: mësimdhënësve, profesorëve, famullitarëve, katekistëve, përgjigjesve të grupeve të ndryshme; dhe së fundi arsytimi i tij i drejtohet edhe të edukuarve, qofshin ata fëmijë, adoloshentë, të rinj, apo të rritur. Me pak fjalë: ka materil të bollshëm për të gjithë.

Studimi që na dhurohet në këtë libër është një përmbledhje mbi linjat udhërrëfyese dhe mbi nxitjet baritore që Carlo Maria Martini ka në shkrimet e tij, për sa i përket sfidave të edukimit, qoftë në kontesktin e dioqezës së tij, qoftë në kontekstin e Kishës së gjithmbarshme, dhe të sfidave që bota bashkëkohore i parqet Kishës në fushën e edukimit”.

*Don Domenik Qerimi*

**AZB 6005 Luzern  
Post CH AG**  
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:  
Nr. 2/2022  
15. Juni 2022

Erscheint im  
Juli 2022

**Impressum**  
Misioni Katolik Shqiptar në Luzern  
Katholische Albaner Mission in Luzern

**Verlag und Redaktion**  
Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës  
Rodteggstrasse 6  
CH-6005 Luzern  
Tel: +41 41 250 52 60  
Fax: +41 41 250 52 67  
Cel: +41 79 371 68 91  
E-Mail: ukas\_cr@hotmail.com  
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch

Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins  
der katholischen Albaner Mission in Luzern.

## ***In memoriam të Arbër Gojanit (1985–2022)***

Pas një sëmundje të rëndë dhe pas përpjekjeve të shumta të mjekëve dhe familjarëve për shërim, me 06 shkurt 2022, në Luzern, ka ndërruar jetë Arbër Gojani nga Radolloci i Klinës me banim në Zvicër. Lajmi për vdekjen e tij ishte padyshim, një lajm i hidhur për të gjithë.

Arbëri, në moshën 36 vjeçare, la pas vetes bashkëshorten me dy fëmijë të mitur, prindërit, një vëlla dhe një motër.

Megjithëse është e vështirë të pranohet dhe të kuptohet, Jezusi na ka mësuar ta kuptojmë vdekjen, si kapërcim drejt takimit me Hyjin që na ka krijuar dhe atij i përkasim për ne të krishterët. Kjo është shpresa e krishterë që njeriun besimtarë e mbush me ngushëllim.

Meshën e shenjtë të dritës e ka udhëhequr don Anton Uka, në bashkë-meshim me don Albert Jakaj, misionar në Aarau. Të pranishme ishin edhe motrat Bijat e Dashurisë Hyjnore nga Misioni i Luzernit. Në predikim don Antoni theksoi dy gjëra interesante. Fillimisht tha se Arbëri pranoi sakramentin e vajimit ditën e premte, ditë në të cilën kujtojmë mundimet dhe vdekjen në kryq të Zotit tonë Jezu Krishtit, dhe ndërroi jetë ditën e diele, ditë kjo në të cilën kujtojmë ngjalljen e Jezu Krishtit, shpëtimtarit tonë dhe

të botës mbarë. Kjo është feja dhe shpresa e krishterë, përmes vdekjes kalojmë në jetën e pasosur, theksoi don Antoni.

Në përfundim të Meshës, njëri nga familjarët, ka lexuar një biografi të shkurtër, përmes së cilës ka shpalosur disa përvoja nga jeta e Arbërit dhe njëkohësisht ka ftuar familjarët dhe të pranishëm që të mbahen të fortë duke besuar dhe shpresuar në premtimet e fesë: “Thuhet se shpresa vdes e fundit, por, për ne që jemi ende shtegtar në këtë botë, kjo shpresë dhe kjo përpjekje për shërimin tënd vërtet u shua të dielën e 6-të shkurtit, por ne besojmë se ti tani gëzon në Hyjin, me engjëjt dhe shenjtërit e Tij, ne besojmë se ti do të lutesh për ne, derisa një ditë të gjithë do të takohemi në mbretërinë qiellore”.

Pas Meshës është vazhduar në procesion drejt varrezave, në oborrin e Kishës në Root, ku është varrosur Arbëri.

Të pranishëm në Meshë dhe në varrim ishte një turmë i madh njerëzish.

Arbri pushoftë në paqe!

*Shkruan: m. Vida Ademi*